



# Bazat e mbulimit shëndetësor

GJITHSHKA QË DUHET TË DINI MBI MARRJEN  
E MBULIMIT





# Përmbajtja

<b>4</b>	<i>Washington Healthplanfinder</i>
<b>5</b>	Terma kryesorë
<b>6-7</b>	Bazat e një plani shëndetësor
<b>8</b>	Përfitimet
<b>9</b>	Ndihmë financiare
<b>10</b>	Washington Apple Health (Medicaid)
<b>11</b>	Zgjedhja e një plani shëndetësor
<b>12-14</b>	Cascade Care
<b>15-16</b>	Kur të bëni kërkesën
<b>17</b>	Lista e gjërave për të bërë kërkesën
<b>18-23</b>	Si të bëni kërkesë
<b>23</b>	Na ndiqni!

# Washington Healthplanfinder

## Ç'farë është *Washington Healthplanfinder*?

*Washington Healthplanfinder* është vendi për të blerë një plan shëndetësor në internet në Washington. Banorët në Washington mund të gjejnë një plan shëndetësor që funksionon për ta përmes nesh.

*Washington Healthplanfinder* ofron plane dhe kursime që nuk janë në dispozicion gjatë. Planet e Cascade Care ofrojnë më shumë shërbime dhe kursime sesa shumë plane të tjera. Programe të kursimit, si kredi të taksave, mund të pakësojnë koston e premimeve tuaja. Nuk do t'i gjeni këto përfitime gjëkund tjetër.

## Si t'a përdor *Washington Healthplanfinder*?

Është e kollajtë për të bërë kërkesë për një plan shëndetësor me *Washington Healthplanfinder*. Mund të regjistroheni dhe të blini në [wahealthplanfinder.org](http://wahealthplanfinder.org), aplikacionin WAPlanfinder ose përmes telefonit.



Vizitoni faqen tonë në internet  
**WAPlanfinder app**



Shkarkoni aplikacionin  
**[wahealthplanfinder.org](http://wahealthplanfinder.org)**

## Pyetje? Telefoni Ndhmës për klientin.

Qendra jonë e ndihmës për klientin ofron ndihmë në mbi 200 gjuhë.



Na telefononi: **1-855-923-4633**  
TTY: **1-855-627-9604**

# Terma kryesorë

Këto terma janë çelësi i kuptimit të planit tuaj shëndetësor.

## ► Premiumi

Premiumi juaj është shuma që paguani çdo muaj për planin tuaj shëndetësor. Duhet të paguani premiumin tuaj edhe nëse nuk merrni asnjë shërbim të kujdesit shëndetësor.

## ► Ndarja e kostos

Ndarja e koston i referohet shumës së kostove të kujdesit shëndetësor që paguani. Ky term përfshin zbritjet, bashkësigurimin dhe bashkëpagesën.

## ► Zbritja

Zbritja juaj është shuma që duhet të shpenzoni për kujdesin përpara sesa plani juaj shëndetësor të fillojë të mbajë koston. Shuma juaj e zbritjes fillon në fillim të secilit vit.

## ► Bashkëpagesa

Një bashkëpagesë është shumë që paguani për një shërbim të mbuluar të kujdesit shëndetësor. Bashkëpagesa juaj duhet të paguhet kur merrni shërbimin.

## ► Bashkësigurimi

Bashkësigurimi është pjesa juaj e koston së një shërbimi të kujdesit shëndetësor të mbuluar. Filloni të paguani bashkësigurimin tuaj pasi keni paguar zbritjen e planit tuaj shëndetësor.

## ► Nga xhepi

Kostot Nga xhepi janë ato që paguani për kujdesin shëndetësor. Mund të përfshijnë zbritjen, bashkësigurimin dhe bashkëpagesat tuaja. Çdo shumë që nuk mbulohet nga plani juaj shëndetësor është një kosto nga xhepi.

## ► Rrjeti

Rrjeti është lista e ofruesve që mbulon plani juaj shëndetësor. Ofruesit në rrjet janë miratuar nga plani juaj shëndetësor. Ofruesit janë rrjetit nuk janë miratuar nga plani juaj shëndetësor.

# Bazat e një plani shëndetësor

## Ç'farë është një plan shëndetësor?

Blini një plan shëndetësor çdo vit në rast se ju ose familja juaj ka nevojë për kujdes shëndetësor. Kompania e sigurimit tuaj paguan një pjesë të kostos së kujdesit shëndetësor kur keni një plan shëndetësor.

## Pse më duhet një plan shëndetësor?

Edhe njerëzit e shëndetshëm përdorin sistemin e kujdesit shëndetësor. Marrja e një plani shëndetësor siguron se kostot e kujdesit shëndetësor janë të përballueshme kur ju nevojitet. Mund të merrni kujdes parandalues për të qëndruar të shëndetshëm nëse jeni të shëndetshëm. Mund të merrni trajtim shpejt nëse nuk jeni të shëndetshëm. Një plan shëndetësor ofron një mënyrë të përballueshme për të marrë kujdes mjekësor kur ju nevojitet.



### Një plan shëndetësor për të ardhmen

Nuk e dini kurrë se kur do t'ju duhet të shkoni tek doktori. Të paturit e një plani shëndetësor siguron se mund të përballoni të merrni kujdes mjekësor kur ju nevojitet.

Edhe nëse jeni të shëndetshëm, plani juaj shëndetësor ju ndihmon të qëndroni të shëndetshëm.



### Investoni në shëndetin tuaj

Kostot e kujdesit shëndetësor mund të jenë të shtrenjta pa një plan shëndetësor. Vizitat rutinë shtohen shpejt. Kostoja e kujdesit për një dëmtim të papritur ose sëmundje të rëndë mund të zbrazë kursimet tuaja.

Mund të kurseni shumë në të ardhmen duke shpenzuar pak në një plan shëndetësor sot.

## Ç'farë është Ligji mbi kujdesin e përballueshëm?

Me miratimin e Ligjit për Kujdesin e Përballueshëm, shteti i Washington-it krijoi *Washington Healthplanfinder*. Qëllimi i Ligjit mbi kujdesin e përballueshëm është të bëjë që kujdesi shëndetësor të kushtojë më pak. Më shumë njerëz se kurrë mund të marrin një plan shëndetësor për pak ose aspak kosto. Gjendja juaj mund t'u kualifikojë për Washington Apple Health (Medicaid) ose përfitime që pakësojnë shumën që paguani për mbulim.

Mund të bëni kërkesë për mbulim shëndetësor falas ose me kosto të ulët në [wahealthplanfinder.org](http://wahealthplanfinder.org) dhe aplikacionin WAPlanfinder.

## Po nëse nuk marr një plan shëndetësor?

Do të paguani koston e plotë të kujdesit shëndetësor pa një plan shëndetësor. Vaksinat e gripit mund të kushtojnë \$50. Një qëndrim tre-ditor në spital kushton dhjetëra mijëra. Trajtimi për kancer mund të shkojë deri në qindra mijëra.

Gjithashtu mund të merrni një ndëshkim në taksa nëse nuk keni mbulim. Në Washington, merrni një për secilin person në familjen tuaj.

## Sa kushton kujdesi?

Këtu janë disa prej trajtimeve më të zakonshme dhe sa kushtojnë. Plani juaj shëndetësor mund të ndajë kosto si këto me ju.

TRAJTIMI	KOSTOJA
Operacion i zemrës	\$78,585
Mamografi	\$263
Operacion i shtyllës kurrizore	\$13,255
Kolonoskopi	\$1,484
Lindje me operacion	\$18,098
Vizitë për kujdes urgjent	\$181
Ekzaminim i kontrollit (për adoleshentë)	\$117
Vizitë tek urgjenca	\$579

# Përfitimet

## Ç'farë mbulon një plan shëndetësor?

Të gjitha planet shëndetësore mbulojnë këto dhjetë përfitime thelbësore shëndetësore. Disa plane, si planet e Cascade Care, mbulojnë më shumë.

### Përfitimet thelbësore shëndetësore

- Vizita tek doktori dhe shtrime në spital
- Vizita tek urgjenca
- Kujdes përpara lindjes
- Shërbime të kujdesit mendor dhe trajtim për abuzimin e substancave
- Ilaçe me recetë
- Shërbime të rimëkëmbjes kur dëmtoheni
- Analiza laboratorike
- Shërbime parandaluese
- Menaxhim të sëmundjeve kronike
- Kujdes pediatrik

### ► Cascade Care

Mund të merrni akses për më shumë shërbime dhe kursime se kurrë më parë me një plan të Cascade Care.

### ► Asnjë mohim

Nuk do t'ju mohoet mbulim për shkak të sëmundjeve ekzistuese paraprake.

### ► Cilësia e kujdesit

Shumë plane shëndetësore ofrojnë një cilësi më të lartë të kujdesit sesa ai që merrni kur nuk jeni të mbuluar.

### ► Kujdes parandalues falas

Shërbime si kontrole dhe vaksina janë plotësisht të mbuluara.



# Ndihmë financiare

## Ç'farë janë kreditë e taksave?

Kreditë e taksave pakësojnë shumën që paguani për planin tuaj shëndetësor çdo muaj. Paguhet nga qeveria dhe zbatohen ndaj premiumit të planit të kujdesit tuaj shëndetësor. Kreditë e taksave janë në dispozicion vetëm përmes *Washington Healthplanfinder*.

## Kush mund të marrë kreditë e taksave?

Shuma e kredive të taksave që merrni varet në të ardhurat dhe madhësinë e familjes tuaj. Sa më të ulta të ardhurat e familjes, aq më të larta kreditë e taksave për të cilat mund të kualifikoheni. Kjo shumë llogaritet kur regjistroheni. Mund të kualifikoheni për kreditë e taksave nëse këto gjëra janë të vërteta:

- ▶ Nuk kualifikoheni për Washington Apple Health (Medicaid) ose Medicare.
- ▶ Nuk keni sigurim përmes punës tuaj ose një programi tjetër qeveritar.
- ▶ Jeni një shtetas i SH.B.A.-së ose me banim të ligjshëm në SH.B.A. dhe jetoni në Washington.
- ▶ Nëse jeni i martuar, nuk paraqisni një dokument të taksave të të Martuarit që paraqet veçmas.

## Ç'farë është Cascade Care Savings?

Programi Cascade Care Savings pakëson koston e premiumit të planit tuaj shëndetësor. Nëse kualifikoheni, shteti do të paguajë një pjesë të premiumit tuaj.

## Kush mund të marrë Cascade Care Savings?

Mund të kualifikoheni për Cascade Care Savings nëse këto gjëra janë të vërteta:

- ▶ Të ardhurat tuaja janë më pak se 250% e Nivelit federal të varfërisë.
- ▶ Nuk kualifikoheni për Washington Apple Health (Medicaid) ose Medicare.
- ▶ Jeni të regjistruar në një plan Cascade Care Silver ose Gold.
- ▶ Nëse kualifikoheni për kreditë e taksave, keni pranuar shumën e plotë që mund të merrni.

# Washington Apple Health (Medicaid)

## Ç'farë është Apple Health?

Apple Health është emri për Medicaid në Washington. Mbulon të gjitha përfitimet thelbësore shëndetësore. Shumë njerëz mund të marrin Apple Health pa asnjë kosto. Disa mund të duhet të paguajnë një premium mujor.

Mund të bëni kërkesë për Apple Health në çdo kohë përmes *Washington Healthplanfinder*.



## Kush mund të marrë Apple Health?

Mund të merrni Apple Health nëse këto tre gjëra janë të vërteta. Krijoni një llogari ose hyni në *Washington Healthplanfinder* nëse nuk e dini nëse kualifikoheni.


- ▶ Të ardhurat tuaja janë nën 138% të Nivelit federal të varfërisë.
- ▶ Nëse jeni një shtetas i SH.B.A.-së ose keni qënë me banim të ligjshëm në SH.B.A. për pesë vjet.
- ▶ Jeni nën moshën 65 vjeç.

# Zgjedhja e një plani shëndetësor

**Mos e ndërlikoni. Gjetja e planit të duhur mund të jetë e kollajtë.**

Ka shumë për të mendur kur zgjidhni një plan shëndetësor. Mund të kualifikoheni për shumë plane, por nuk jeni të sigurtë se cili është më i miri për nevojat tuaja. Plane të ndryshëm ofrojnë përfitime të ndryshme. Planet e Cascade Care përdorni ndarjen e kostos standarte për të ofruar përfitimet më të mira për secilin nivel të metalit.

Pyetjet më poshtë mund t'ju udhëzojnë drejt planit shëndetësor të duhur.



- ▶ **Sa mund të paguaj çdo muaj?**  
Premiumet mujore ndryshojnë mes planeve shëndetësore.
- ▶ **A duhet të zgjedh një mjek të kujdesit kryesor?**  
Disa plane ju ofrojnë një.
- ▶ **A është doktori im i tanishëm në rrjetin e planit?**  
Sigurohuni që doktori juaj i tanishëm është i mbuluar.
- ▶ **A kam nevojë për një referim me shkrim për të parë një specialist?**  
Disa plane kërkojnë referime me shkrim.
- ▶ **Sa e kollajtë është të ndryshoj doktorë?**  
Mund të dëshironi të ndryshoni doktorë në të ardhmen.
- ▶ **A ka një zbritje?**  
Duhet të përmbushni zbritjen tuaj përpara sesa plani juaj të ndajë kostot tuaja..
- ▶ **Cilat janë kostot nga xhepi të këtij plani?**  
Kostot nga xhepi shtohen me vizita të shpeshta.
- ▶ **Si i trajton ky plan vizitat tek urgjenca?**  
Dini se ç'farë të bëni në rast të urgjencës.
- ▶ **A jam duke pritur ndonjë shpenzim të madh mjekësor gjatë vitit të ardhshëm?**  
Mund të dëshironi më shumë mbulim nëse jeni duke pritur një fëmijë ose shpenzim tjetër të madh.

# Cascade Care

## Ç'farë janë planet e Cascade Care?

Planet e Cascade Care janë një lloj i Planit shëndetësor të kualifikuar në dispozicion përmes *Washington Healthplanfinder*. Mbulojnë përfitimet thelbësore shëndetësore dhe ofrojnë më shumë shërbime dhe kursime sesa shumë plane.

Ka dy lloje të planeve të Cascade Care: Planet Cascade dhe planet Cascade Select. Planet Cascade Select duhet të përmbushin standarte më të larta. Ofrojnë më shumë cilësi dhe vlerë sesa plane të tjera.



## Pse duhet të zgjedh një plan të Cascade Care?

Planet e Cascade Care ofrojnë më shumë mbulime për më pak kosto. Mbulojnë më shumë shërbime sesa shumica e planeve përpara sesa të duhet të përmbushni zbritjen. Kjo përfshin kujdesin kryesor, shërbimet e shëndetit mendor, ilaçet e përgjithshme dhe më shumë.

Gjithashtu kurseni në kostot nga xhepi. Mesatarisht, zbritja juaj është \$1,000 më pak nëse zgjidhni një plan të Cascade Care.

## Si funksionojnë planet e Cascade Care?

Planet e Cascade Care përdorin një skemë standarte të ndarjes së koston. Kjo do të thotë disa gjëra. Së pari, kostot nga xhepi mbeten të njëjta ndërmjet kompanive. Të gjitha planet e Cascade Care në secilin nivel të metalit përdorin të njëjtën zbritje, bashkëpagesa dhe bashkësigurim.

Së dyti, planet e Cascade Care përdorin të njëjtin mbulim. Mbulojnë të njëjtat shërbime përpara sesa të përmbushet zbritja. Mund të qetësoheni duke ditur se keni mbulesën më të mirë në dispozicion.

## Më shumë zgjidhje. Më shumë vlerë.

Planet Cascade dhe Cascade Select ju japin më shumë opsione dhe më shumë vlerë. Skema e tyre e ndarjes së kostos standarte siguron se merrni mbulimin më të mirë që të mundeni.

Planet e Cascade Care janë në dispozicion vetëm përmes *Washington Healthplanfinder*. Futuni në llogarinë tuaj për të parë nëse kualifikoheni.



Planet në dispozicion në *Washington Healthplanfinder*

	Planet jo të Cascade	Planet e Cascade	Planet e zgjedhur të Cascade
Kualifikohen për kredi të taksave	✓	✓	✓
Kualifikohet për Cascade Care Savings		✓	✓
Plani shëndetësor i kualifikuar (duhet të përmbushë standartet e cilësisë)	✓	✓	✓
Mbulon të gjitha dhjetë përfitimet thelbësore shëndetësore	✓	✓	✓
Ndarje e kostos e standartizuar (planet ndajnë të njëjtën shumë të zbritshme, bashkë-pagesa dhe bashkë-sigurim)		✓	✓
Mbulon kujdesin kryesor, kujdesin urgjent, kujdesin për shëndetin mendor, ilaçe të përgjithshme dhe më shumë përpara sesa të përmbushet shumica e zbritshme		✓	✓
Ofruar vetëm nga <i>Washington Healthplanfinder</i>		✓	✓
Ofruar në çdo qark në Washington	✓	✓	

# Kur të bëni kërkesë

## Kur mund të bëj kërkesë për një plan shëndetësor?

Mund të bëni kërkesë për një plan shëndetësor gjatë regjistrimit të hapur. Regjistrimi i hapur është periudha e vitit për të blerë Plane shëndetësore të kualifikuar dhe Plane dentare të kualifikuar në *Washington Healthplanfinder*. Ai fillon me 1 nëntor çdo vit.

## Po nëse kam nevojë për mbulim përpara regjistrimit?

Disa ndryshime në jetë ju lejojnë të regjistroheni për një plan shëndetësor në çdo periudhë të vitit. Ky quhet regjistrim special. Mund të bëni kërkesë për regjistrimin special deri në 60 ditë pasi ka ndodhur një ngjarje kualifikuese e jetës.

### Ngjarje kualifikuese të jetës

- Martesë
- Hyrja në një partneritet shtëpiak
- Lindje
- Adoptim ose kujdes i kujdestarisë
- Dalje para kohe në pension
- Humbja e një personi të varur ose status i varësisë për shkak të vdekjes, divorcit ose ndarjes ligjore
- Një ndryshim në të ardhura
- Humbja e sigurimit tjetër shëndetësor
- Humbja e mbulimit falas COBRA
- Ardhja me banim në Washington
- Shkuarja me banim në një vend tjetër
- Një ndryshim në shtetësi ose në statusin e pranisë së ligjshme
- Lirimi nga burgu
- Marrja e një urdhëri gjyqësor (përfshirë ndihmë për fëmijë)



## Familjet me të ardhura të ulta

Familjet me të ardhura të ulat mund të bëjnë kërkesë për regjistrim special në çdo kohë. Një ngjarje kualifikuese e jetës nuk është e nevojshme. Duhet të fitoni më pak se 250% e Nivelit federal të varfërisë për të marrë këtë përfitim.

## Individët AI/AN dhe anëtarët e fiseve

Rregullat e regjistrimit nuk zbatohen për anëtarët e fiseve dhe aksionerët e Korporatës amtare të Alaskës. Mund të regjistroheni në çdo periudhë të vitit. Gjithashtu mund të ndryshoni planin tuaj një herë në muaj nëse zgjidhni t'a bëni atë.





# Lista e gjërave për të bërë kërkesën

## Ç'farë më nevojitet për të bërë kërkesën?

Washington Healthplanfinder ka nevojë për njëfarë informacioni thelbësor rreth jush kur bëni kërkesë për një plan shëndetësor. Përdorni listën e gjërave për të bërë më poshtë për t'u siguruar se keni atë që ju nevojitet.



### **Emrat ligjorë dhe datëlindjet**

Do t'ju nevojitet emri ligjor dhe datëlindja e secilit person që bën kërkesë për mbulim.



### **Numrat e sigurimit social**

Kini gati numrin e sigurimit social për secilin person që bën kërkesë nëse kanë një të tillë. Mund të bëni kërkesë edhe nëse nuk keni një të tillë.



### **Statusi jo-shtetas**

Mund të duhet të dimë statusin tuaj nëse jeni një jo-shtetas. Ju ose anëtarët e familjes tuaj mund të marrin mbulim edhe nëse kjo është e vertetë.



### **Statusi i të ardhurave dhe paraqitjes së taksave**

Mblidhni çdo informacion mbi të ardhurat që keni për secilin person që bën kërkesë. Kjo mund të përfshirë formularët W-2 dhe dokumentat e marra nga zyra e taksave.



### **Informacion tjetër i sigurimit**

Mund të keni opsione të tjera të sigurimit shëndetësor, si Medicare, Tri-Care ose mbulim bazuar tek puna. Mblidhni këtë informacion kur bëni kërkesë.

# Si të bëni kërkesë

## Kam gjithshka që më nevojitet! Tani ç'të bëj?

Mund të bëni kërkesë për mbulim në [wahealthplanfinder.org](http://wahealthplanfinder.org), aplikacionin WAPlanfinder ose përmes telefonit.



### Regjistrohuni në internet në [wahealthplanfinder.org](http://wahealthplanfinder.org)

Krijoni një llogari, blini plane shëndetësore dhe gjeni informacion të dobishëm në [wahealthplanfinder.org](http://wahealthplanfinder.org).



### Na telefononi në 1-855-923-4633

Ndihma për klientin është e disponueshme përmes telefonit nga 7:30 paradite deri në 5:30 pasdite, nga e hëna tek e premtja.



### Shkarkoni aplikacionin WAPlanfinder

Aplikacioni ynë celular është në dispozicion në Apple App Store dhe Google Play.

## Klikoni. Krahasoni. Të mbuluar.

Është e kollajtë të gjeni planin e duhur për nevojat tuaja përmes *Washington Healthplanfinder*. Pavarësisht nëse përdorni [wahealthplanfinder.org](http://wahealthplanfinder.org) ose aplikacionin WAPlanfinder, ndërmerri këto hapa të thjeshtë.

1

### Blini dhe krahasoni

Jepni moshën tuaj, përdorimin e duhanit dhe të ardhurat e përllogaritura. Do të merrni një listë të planeve shëndetësore që mund të merrni dhe premiumet e tyre.

3

### Zgjidhni një plan

Mund të keni shumë opsione bazuar në gjendjen tuaj. Zgjidhni planin më të mirë për ju dhe për nevojat e familjes tuaj.

2

### Bëni kërkesë

Futni më shumë informacion, si statusi i paraqitjes së taksave dhe burimet e të ardhurave. Kjo do t'ju lejojë të shihni nëse kualifikoheni për ndihmë financiare, Washington Apple Health (Medicaid) ose një Plan shëndetësor të kualifikuar.

4

### Mbulohuni

Pasi keni konfirmuar planin tuaj shëndetësor të zgjedhur, do të mbuloheni shpejt. Paguani faturën tuaj të premiumit të parë kur t'a merrni për të filluar mbulimin. Do të merrni një kartë të sigurimit nga kompania që zgjodhët.

## Merrni ndihmë me kërkesën tuaj.

Kemi partneritet me ekspertë rreth e qark shtetit që mund t'ju udhëzojnë përmes procesit të regjistrimit. Këta ekspertë quhen ndërmjetës dhe drejtues. Këta njerëz mund t'u përgjigjen pyetjeve tuaja rreth planeve shëndetësore ose si të regjistroheni. Ata gjithashtu mund t'ju thonë nëse kualifikoheni për ndihmë financiare.

Ndihma nga ndërmjetësit dhe drejtuesit zakonisht është falas. Kërkoni për një të tillë në zonën tuaj në [wahealthplanfinder.org](http://wahealthplanfinder.org) ose në aplikacionin WAPlanfinder.

## Qendrat e rregjistrimit me drejtues dhe ndërmjetës sipas qytetit

### **Bellingham**

Rice Insurance

1400 Broadway Street, Bellingham, WA 98225

*Telefoni:* 1-360-734-1161

*Email:* keith@riceinsurance.com

---

### **Everett**

Health Insurance Solutions NW, LLC

7003 Evergreen Way, Suite B, Everett, WA 98203

*Telefoni:* 1-425-252-5105

*Email:* neil@his-nw.com

---

### **Federal Way**

Public Health Seattle & King County

1640 S 318th Place, Federal Way, WA 98003

*Telefoni:* 1-800-756-5437

*Email:* chap@kingcounty.gov

---

### **Kennewick**

Advisor Health Benefits Group

1446 Spaulding Ave, Suite 302, Richland, WA 99352

*Telefoni:* 1-509-524-9611

*Email:* kevin@advisorhealthbenefits.com

---

### **Seattle**

Financial Designs

2723 California Avenue SW, Seattle, WA 98116

*Telefoni:* 1-425-392-7390

*Email:* cmclure@financialdesignsinsurance.com

### **Spokane**

Better Health Together Enrollment Center  
157 S Howard, Ste 102, Spokane, WA 99201  
*Telefoni:* 1-509-370-5605  
*Email:* [bhtnavigatorstaff@BetterHealthTogether.org](mailto:bhtnavigatorstaff@BetterHealthTogether.org)  
*Faqja në internet:* [www.betterhealthtogether.org/navigators](http://www.betterhealthtogether.org/navigators)

---

### **Tacoma**

FND Insurance & Financial Services, LLC  
5515 Steilacoom Blvd SW, Suite 122, Lakewood, WA 98499  
*Telefoni:* 1-253-302-5579  
*Email:* [teamfnd@fndinsurance.com](mailto:teamfnd@fndinsurance.com)

---

### **Vancouver**

Applied Team Insurance  
8513 NE Hazel Dell Avenue, Suite 101, Vancouver, WA 98665  
*Telefoni:* 1-360-726-6092  
*Email:* [marlena@appliedteamins.com](mailto:marlena@appliedteamins.com)

---

### **Wenatchee**

Suzie Health Insurance  
413 N Mission Street, Wenatchee, WA 98801  
*Telefoni:* 1-509-295-9055  
*Email:* [info@wahbroker.org](mailto:info@wahbroker.org)

---

### **Yakima**

Yakima Neighborhood Health Services  
610 Yakima East Avenue, Yakima, WA 98901  
*Telefoni:* 1-509-853-2377  
*Email:* [navigators@ynhs.org](mailto:navigators@ynhs.org)

## Qendrat e regjistrimit me drejtues sipas qarkut

### **Adams, Ferry, Lincoln, Pend Oreille, Spokane, Stevens ose Whitman County**

Better Health Together

*Telefoni:* 1-509-381-5573

*Email:* [bhtnavigatorstaff@BetterHealthTogether.org](mailto:bhtnavigatorstaff@BetterHealthTogether.org)

*Faqja në internet:* [www.betterhealthtogether.org/navigators](http://www.betterhealthtogether.org/navigators)

---

### **King, Clallam ose Jefferson County**

Public Health Seattle & King County

*Telefoni:* 1-800-756-5437

*Email:* [chap@kingcounty.gov](mailto:chap@kingcounty.gov)

---

### **King, Pierce, Snohomish, Thurston County**

Korean Women's Association

*Telefoni:* 253-535-4202

*Faqja në internet:* [www.kwacares.org](http://www.kwacares.org)

---

### **Chelan, Douglas, Grant ose Okanogan County**

Confluence Health/Wenatchee Valley Hospital

*Telefoni:* 1-509-433-3383

*Email:* [sm\\_ch\\_lead\\_org@confluencehealth.org](mailto:sm_ch_lead_org@confluencehealth.org)

---

### **Kitsap County**

Peninsula Community Health Services

*Telefoni:* 1-360-377-3776

*Email:* [eligibility@pchsweb.org](mailto:eligibility@pchsweb.org)

---

### **Clark, Cowlitz, Grays Harbor, Klickitat, Lewis, Mason, Pacific, Pierce, Thurston, Snohomish, Skagit, Skamania, Wahkiakum ose Whatcom County**

Sea Mar Community Health Centers

*Telefoni:* 1-855-289-4503

*Email:* [seamaripa@seamarchc.org](mailto:seamaripa@seamarchc.org)

## Asotin, Benton, Columbia, Franklin, Garfield ose Walla Walla County

Tri-Cities Community Health

Telefoni: 1-509-543-1952

Email: [enrollmentHBE@mytcch.org](mailto:enrollmentHBE@mytcch.org)


Faqja në internet: [www.mytcch.org](http://www.mytcch.org)

## Kittitas ose Yakima County

Yakima Neighborhood Health Services




Telefoni: 1-509-853-2377

Email: [navigators@ynhs.org](mailto:navigators@ynhs.org)



# Na ndiqni!

Shpërndarjmë informacion të dobishëm dhe përditësime të regjistrimit në këta kanalë sociale.

-  Washington Healthplanfinder
-  [waplanfinder](#)
-  [waplanfinder](#)



washington  
**healthfinder**

click. compare. covered.

[wahealthplanfinder.org](http://wahealthplanfinder.org)  
1-855-WAFINDER | 1-855-923-4633